


RAPORT

Komiteti për Monitorimin e Kartës së Qytetit

KARTA E QYTETIT

"E DREJTA MBI QYTETIN E PRIZRENIT"



DHJETOR, 2021

RAPORT

Komiteti për Monitorimin e Kartës së Qytetit

KARTA E QYTETIT

"E DREJTA MBI QYTETIN E PRIZRENIT"

DHJETOR, 2021

PËRMBAJTJA

KARTA E QYTETIT - HYRJE	3
1.0 MONITORIMI I ANGAZHIMEVE DHE VEPRIMEVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT RRETH PËRMBUSHJES SË DISPOZITAVE TË KARTËS SË QYTETIT	4
1.1 QEVERISJA E MIRË	4
1.2 PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE GJITHËPËRFSHIRJA	5
1.3 REFORMIMI URBAN	7
1.4 TË DREJTAT E NJERIUT	8
1.5 TË DREJTAT E QYTETARËVE PËR ÇASJE NË DOKUMENTACION PUBLIK DHE INFORMIM	8
1.6 BARAZIA GJINORE	8
1.7 QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE	9
1.8 SIGURIA PUBLIKE	10
1.9 SHËRBIME TË QASSHME PUBLIKE PËR GRUPET E MARGJINALIZUARA, ME THEKS NË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	11
1.10 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM URBAN	11
1.11 SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE TË KËNAQSHME PËR QYTETARËT	12
1.12 KULTURA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE	14
2.0 TAKIMET KONSULTATIVE ME PËRFAQËSUESIT E GRUPEVE TË KOMUNITETIT TË SPECIFIKUARA SIPAS KARTËS SË QYTETIT	16
KONKLUZA	19

Raport i monitorimit dy vjeçar nga **Komiteti për Monitorimin e Kartës së Qytetit**

Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e rregullt të datës 26 Tetor 2018, me propozim të OJQ "EC Ma Ndryshe", miratoi Kartën e Qytetit, ndërsa më 27 Mars 2019 u emërua Komiteti i përbashkët për "Kartën e Qytetit" me përfaqësim nga 4 anëtarë të KK-së dhe 4 aktivistë të shoqërisë civile.

Karta e Qytetit si dokument është miratuar dhe aprovuar me qëllim që të promovojë dhe të fuqizojë të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit, në kuadër të menaxhimit të përgjithshëm të qytetit. Vlerat të cilat i promovon ky dokument fokusohen në: 1. Dinjitetin e qytetarëve, 2. Lirinë, Barazinë dhe Mos diskriminimin, 3. Pjesëmarrjen e qytetarëve dhe gjithëpërfshirjen në politikat publike të Komunës, 4. Qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore si dhe 5. Bashkëpunimin dhe solidaritetin mes qytetarëve si dhe të Komunës me qytetarët dhe anasjelltas.

Ndër të drejtat themelore mbi Qytetin e Prizrenit, dokumenti specifikon: Të drejtën mbi Qytetin; Të drejtën për pjesëmarrje; Të drejtën për siguri publike; Të drejtën për shërbime të qasshme publike; Të drejtën për informim; Të drejtën për zhvillim të qëndrueshëm urban; Të drejtën për strehim dhe shërbime sociale; Të drejtën kulturore; Të drejtën lidhur me trashëgiminë kulturore[1].

Bazuar në këto parime dhe të drejta në bazë të të cilave është përpiluar dokumenti Karta e Qytetit, Komiteti për mbikqyrjen e tij, në përbërje të: Flaka Xërxa Beqiri (Kryesuese), Mybexhele Zhuri, Rreze Hoxha, Ilir Gashi, Mimoza Çeku – Rogova, Elmedina Dorambari dhe Nuhi Salihu, Memnuna Ajdini e cila më vonë është zëvendësuar me Sabina Danan xjerr këtë raport dy vjeçar i cili mëton evaluimin e zbatimit të Kartës së Qytetit nga Komuna e Prizrenit, respektivisht organet përgjegjëse të ngarkuara sipas Kartës.

Ky raport është i bazuar në (1) monitorimin e vazhdueshëm të veprimeve dhe angazhimeve konkrete të Drejtorive Komunale të Komunës së Prizrenit si dhe poashtu në (2) takimet konsultative me përfaqësuesit e grupeve të komunitetit të specifikuar sipas Kartës së Qytetit.

[1] Për më shumë mbi të drejtat e listuara mund të referoheni në dokumentin KARTA E QYTETIT "E DREJTA MBI QYTETIN E PRIZRENIT"

1.0

MONITORIMI I ANGAZHIMEVE DHE VEPRIMEVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT RRETH PËRMBUSHJES SË DISPOZITAVE TË KARTËS SË QYTETIT

Bazuar në vëzhgimin dhe monitorimin e institucioneve relevante në kuadër të Komunës së Prizrenit, Komiteti i Kartës së Qytetit ka vërejtur këto angazhime, veprime por edhe ngecje sa i përket përmbushjës së të drejtave të listuara në kuadër të Kartës së Qyteitit.

1.1 QEVERISJA E MIRË

Komuna e Prizrenit ka ngecur në një qeverisje të drejtë, transparente dhe demokratike sa i takon ekzekutivit, ndaj disa drejtorëve Prokuroria Themelore e Prizrenit ka ngritur aktakuza, edhe pse Kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë ndërrimin e disa prej tyre por jo duke e përmbushur plotësisht premtimin se do të qeverisë me duar të pastra. Lidhur me këtë ka patur reagime edhe nga shoqëria civile, konkretisht EC Ma Ndryshe

Drejtorët me aktakuza:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,704#.YD0oaehKiUk>

Lidhur me mangësitë në qeverisjen e mirë, ka pasur poashtu reagime edhe për mënyrën jo transparente të ndarjes së subvencioneve, posaçërisht nga DKRS, nga e cila drejtori kanë munguar informatat e plota për publikun lidhur me shumën dhe specifikat tjera të përfituesve, informata të cilat do të rrisnin transparencën komunale.

Ndarja e subvencioneve në mënyrë jo transparente:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,729#.YD0otOhKiUk>

Megjithatë, ka patur edhe angazhime rreth rritjes së kualitetit në qeverisje dhe në shërbime ndaj qytetarëve, dhe atë përmes draftimit të rregullores për taksa dhe tarifa për eliminimin e pagesave administrative të pa nevojshme dhe jo-ligjore; largimin e provizionit për pagesat komunale që kapin shifrën në vlerë deri në 9.99 euro; zvogëlimin e normave tatimore për vitin 2021 etj.

Draft rregullore per taksa dhe tarifa:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/draft-rregullorja-per-tarifa-dhe-taksa-komunale-prezantohet-para-audience-me-interes-dhe-qytetareve/>

Pagesat deri 9.99 euro lirohen nga provizioni:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/pagesat-komunale-deri-ne-9-99-euro-nga-nje-marsi-2021-lirohen-nga-provizioni-bankar/>

Zvogëlimi i normave tatimore për vitin 2021:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/nees/komuna-ndihmon-qytetaret-duke-zvogeluar-normat-tatimore-per-vitin-2021/>

Një element i rëndësishëm në rritjen e transparencës ndaj qytetarëve mund të cilësohet ftesa e Komunës së Prizrenit për të pranuar kërkesa për buxhetin 2021, ku qytetarëve u janë dhënë disa alternativa për t'i praqitur kërkesat e tyre, në përshtatshmëri me situatën pandemike (duke u dhënë mundësi që ato t'i bëjnë edhe online bazuar në disa modalitete dhe platforma), po ashtu nuk kanë munguar edhe takimet për KAB për vitin 2022.

Pranimi i kërkesave për buxhetin 2021:

<https://kk.rks->

[gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%8a%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%9a-%f0%9d%90%9e-%f0%9d%90%8f%f0%9d%90%ab%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%b3%f0%9d%90%ab%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%ad/](https://kk.rks-gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%8a%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%9a-%f0%9d%90%9e-%f0%9d%90%8f%f0%9d%90%ab%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%b3%f0%9d%90%ab%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%ad/)

1.2 PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE GJITHËPËRFSHIRJA

Komuna e Prizrenit ka ndërmarrë disa veprime konkrete për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe gjithëpërfshirjen edhe pse të njëjtat nuk kanë rezultuar të jenë të mjaftueshme bazuar në gjendjen aktuale sa i takon faktorit të pjesëmarrjes qytetare dhe gjithëpërfshirjes (bazuar në të dhënat e mbledhura nga takimet me grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit: për më shumë në pjesën e dytë të raportit).

Në rradhën e angazhimeve që shënojnë progres në përmbushjen e kësaj të drejte të specifikuar me Kartën e Qytetit mund të llogaritet projekti i përbashkët në mes UN-Habitat dhe EC Ma Ndryshe me qëllim të intervenimeve direkte në hapësira publike përmes planifikimit urban me pjesëmarrje, praktikisht metodologjisë MINECRAFT, bllok-pas-blloku. Rigjenerimit të hapësirave publike në kuadër të këtij projekti i ka paraprirë një varg diskutimesh publike si dhe punëtoritë dy-ditore. Finalizimi i këtij procesi është shënuar me implementimin e parkut në Lakuriq.

Punëtoritë për dizajnim të hapësirave publike:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,601#.YDOnQ-hKiUk>

Parku në Lakuriq:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,735#.YDOPhKiUk>

Poashtu në kuadër të angazhimit për pjesëmarrje publike, mund të ceket organizimi i takimit me qytetarë me ç'rast Kyretari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka ka prezantuar para tyre Raportin e Punës së Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2020

Takim me qytetarë për raportin 1 vjeçar:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/puna-nje-vjecare-e-komunes-sone-zbardhet-para-qytetareve/>

Lidhur me gjithëpërfshirjen dhe involvimin e të gjitha grupeve të komunitetit në proceset që ndërlihen me të drejtën ndaj qytetit, si rast pozitiv mund të shënohet aktiviteti i Komunës për shpërndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për nxënësit me nevoja të veçanta, pjesë e projektit “Edhe unë jam në mesin tuaj”.

Mirënjohe dhe shpërblime për nxënësit me nevoja të veçanta:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-ndane-mirenjohje-dhe-shperblime-per-nxenesit-me-nevoja-te-vecanta/>

Gjithashtu, nëpërmjet Drejtorisë së Administratës, si dhe Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore, janë punësuar 5 persona me nevoja të veçanta, angazhimi i tyre ishte për një kohëzgjatje prej 3 muajve.

Punësimi i 5 personave me nevoja të veçanta për 3 muaj:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-puneson-pese-persona-me-nevoja-te-vecanta/>

Por, pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet publike e organizuar nga Komuna e Prizrenit ishte tepër e ulët. Komuna duhet ta trajtojë me mjaft seriozitet këtë çështje dhe të ofrojë kushte dhe mekanizma për ta rritur numrin e pjesëmarrësve.

Është realizuar një numër i konsiderueshëm i dëgjimeve publike për çështje të ndryshme:

Draft Rregullore për vendosjen e objekteve të përkohshme:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/draft-rregullorja-per-vendosjen-e-objekteve-te-perkohshme-diskutohet-me-qytetare/>

Draft Rregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e hapësirave publike për parkim dhe largimin e automjeteve të parkuara në mënyrë jo të rregullt, organizimin e vendparkingjeve me ppp, si dhe organizimin e vendparkingjeve private në Komunën e Prizrenit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultimi-publik-per-draft-rregulloren-per-organizimin-dhe-shfrytezimin-e-hapesirave-publike/>

Plotësim ndryshim i rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-mbane-konsultim-publik-per-plotesim-ndryshimin-e-rregullores-per-menaxhimin-e-mbeturinave/>

Raportimi i kryetarit për punën e komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/kryetari-z-mytaher-haskuka-raporton-per-punen-e-komunes-ne-gjashtemujorin-e-pare-te-vitit-2021/>

Dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2022 në Gjonaj:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/sot-filluam-me-degjimet-publike-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2022/>

Dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2022 në Piranë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-degjimi-i-dyte-publik-per-hartimin-e-buxhetit-te-vitit-2022-ne-pirane-me-banoret-e-perdrinise/>

Dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2022 në Zhur:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-degjimi-i-trete-publik-per-hartimin-e-buxhetit-te-vitit-2022-me-banoret-e-rajonit-te-zhurit-verrinit-dhe-vermices/>

Dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2022 në Reqañë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-degjimi-i-katert-publik-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2022-me-banoret-e-rajonit-te-zhupes-dhe-podgores/>

Dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2022 në Korishë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/degjime-publike-per-buxhetin-e-vitit-2022-organizuam-edhe-me-banoret-e-rajonit-te-kabashit/>

Dëgjimi publik në Shtëpinë e Bardhë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/ne-sallen-e-kuvendit-komunal-u-mbajt-degjimi-i-fundit-publik-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2022/>

Në monitorimin e realizuar nga EC Ma Ndryshe në dëgjimet publike për buxhetin e vitit 2022 është vërejtur një numër mjaft i vogël i qytetarëve e posaçërisht i grave. Po ashtu janë disa nga kërkesat esenciale që janë paraqitur në secilin takim si uji i pijes, ndriçimi publik, infrastruktura rrugore etj.

Infografika për dëgjimet publike nga EC:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4467839059996994>

1.3 REFORMIMI URBAN

Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor, Beni Kizolli dhe kryetarin e Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, Masar Dushi, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, përmes së cilës do të mundësohet përfshirja e arkitektëve profesionalë në procesin e regjenerimit të urave dhe hapësirave përcjellëse në të dy anët e Lumbardhit. Sidoqoftë, bazuar në konsultimet me profesionistë dhe akterë të shoqërisë civile, ky proces nuk është qartësuar ende mjaftueshëm për opinionin publik.

Regjenerimi i urave dhe hapësirave përcjellëse në të dy anët e Lumbardhit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/regjenerohen-urat-dhe-hapesirat-percjellese-ne-te-dy-anet-e-lumbardhit/>

Komuna e Prizreni ka filluar realizimin e këtij projekti edhe pse nuk janë siguruar të gjitha pëlqimet nga institucionet përkatëse. Për këtë arsye Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore është detyruar që të bëjë ndalimin e punimeve. Për këtë çështje EC Ma Ndryshe pas sigurimit të të gjitha informatave ka reaguar përmes rrjeteve sociale.

Reagimi nga EC:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4638266232954275>

Gjithashtu, në rradhën e nismave për reformim urban mund të potencohet angazhimi mbi hartimin e dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Prizrenit 2020-2028" i cili ka qenë i hapur për diskutim publik.

Harta zonale:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/harta-zonale-e-komunes-sone-2020-2028-del-ne-diskutim-publik/>

Drejtoria e Inspektorateve ka bërë largimin e billbordeve (tabelave reklamuese), të vendosura në pjesë të ndryshme të qytetit, pa leje të organeve kompetente komunale. Aksionet e tilla janë ndërmarrë edhe viteve tjera në QHPz por nuk kanë patur sukses. Forma të ndryshme të reagimit ka patur edhe nga shoqëria civile. Konkretisht EC ka realizuar edhe një hulumtim lidhur me shenjëzimin kaotik në QHPz.

Largimi i reklamave të vendosura në HP pa leje:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-largon-reklammat-e-vendosura-ne-hapesirat-publike-pa-leje/>

1.4 TË DREJTAT E NJERIUT

Komuna e Prizrenit i është bashkuar fushatës kundër dhunës në baza gjinore duke organizuar debat me temën “E drejta mbi trashëgiminë në pronë, dhe dhuna në familje”. Ky aksion mbetet simbolik, krahasuar me të mungesën në të drejtat themelore me të cilat përballen grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në kuadër të Komunës së Prizrenit (pjesa e dytë e raportit)

Debat me temën “E drejta mbi trashëgiminë në pronë, dhe dhuna në familje”:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/jo-dhunes-ne-baze-gjinore-dhe-familje/>

1.5 TË DREJTAT E QYTETARËVE PËR ÇASJE NË DOKUMENTACION PUBLIK DHE INFORMIM

Komuna e Prizrenit, vrojtuar nga shoqëria civile, ka ngecur në ofrimin e qasjes në dokumentacione publike. Konkretisht EC ka konsideruar se praktika e mosfrimit të qasjes në dokumentin publik përmes zvarritjeve të panevojshme bie ndesh me zotimet e Qeverisë komunale të Prizrenit për transparencë radikale dhe shkel standardet e llogaridhënies ndaj publikut. Në reagimin e kësaj organizate, çështje të ngjajshme janë shfaqur me DUPH duke mos ofruar dokumentet e kërkuara apo edhe duke ofruar përgjigje gjysmake. Pozitive mund të vlerësohet praktika e ofruar për dërgimin e kërkesave në mënyrë elektronike, pa patur nevojë që të protokollohen.

Reagim nga EC:
<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,652#.YDOn10hKiUk>

Mirëpo, Komiteti i Kartës së Qytetit është përballur edhe vetë me vështirësi për të patur qasje në informim dhe dokumentacion publik, ku gjatë përpilimit të këtij raporti ka marrë përgjigje vetëm nga pesë drejtori (në mesin e gjithsej 13 drejtorive) lidhur me plotësimin e pyetësorit për evaluimin e funksionimit të Kartës së Qytetit, duke dëshmuar në këtë mënyrë një jo-gadishmëri institucionale për të qenë të hapur për qytetarët.

1.6 BARAZIA GJINORE

Barazia gjinore mbetet ndër çështjet me më së paku prioritet nga Komuna e Prizrenit (bazuar në përgjigjet e pjesës së dytë të raportit), duke injoruar edhe kërkesat për aprovimin e kodit buxhetor. Nuk mungojnë nisma simbolike, të cilat janë të izoluara dhe në ndihmë vetëm për rastet e veçanta.

Në muajin korrik të vitit 2020 EC ka realizuar performancën publike “Barazia gjinore edhe në emërtime të rrugëve e shesheve publike”. Performanca është realizuar me vendosjen simbolike të disa shenjave të rrugëve me emra grash në Prishtinë, Prizren dhe Graçanicë.

Performanca nga EC:
<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4222158744565028>

Po ashtu është vërejtur diskriminimi gjinor në drejtimin dhe emërtimin e shkollave në 7 komuna më të mëdha në Republikën e Kosovës. Në Komunën e Prizrenit nga 58 drejtorë/drejtoresha shkollash, 48 janë burra dhe 10 janë gra apo 82.8% me 17.2%.

Sidoçoftë, vlenë të theksohet angazhimi i Drejtorisë për Financa dhe zyrës për barazi gjinore në bashkëpunim me OSBE-në për realizimin e Buxhetimit të ndjeshëm gjinor, si pjesë përbërëse e procesit të planifikimit, realizimit dhe monitorimit të projekteve komunale, fillimisht tek subvencionimet.

Gjithashtu, Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka së bashku me Shqipe Breznica nga organizata gjermane “Help” në Kosovë, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi përmes së cilës 30 biznese të udhëhequra nga gratë në Prizren që operojnë në fushën e Efiçencës së Energjisë, do të përfitojnë subvencione, me qëllim të përforcimit të biznesit të tyre.

Bizneset që udhëheqen nga gratë dhe që operojnë në fushën e efiçencës:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/bizneset-qe-udheheqen-nga-grate-dhe-operojne-ne-fushen-e-eficences-se-energjise-do-te-perfitojne-subvencione-2/>

Komuna e Prizrenit ka bërë një hap mjaft të rëndësishëm duke çertifikuar 216 gra të komunës sonë që kanë qenë pjesëmarrëse në kurse artizanale të ndryshme:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/certifikohen-216-gra-te-komunes-sone-ne-kurse-artizanale/>

1.7 QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE

Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë, organizata “Wildlife – Albanian Photographers”, me përkrahjen e Komunës së Prizrenit, ka organizuar ekspozitën fotografike me temë: Shpendët shtegëtarë (migrues).

Ekologjia e shpendëve migrues përmes fotografive:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/ekologjia-e-shpendeve-migrues-permes-fotografive-shpaloset-nga-09-deri12-tetor-tek-sheshi-i-lidhjes/>

Për të krijuar një mjedis më të pastër në qytetin e Prizrenit, komuna ka vendosur stacion për mbushje të biçikletave elektrike në disa pjesë të qytetit.

Stacionet e biçikletave:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/stacionet-e-bicikletave-afer-finalizimit-ne-qtet/>

Për një natyrë të pastër dhe mjedis jetësor të gjelbëruar është shënuar 5 qershori “Dita e mjedisit”, ku është bërë mbjellja e drunjëve dekorativ dhe pastrimi i disa hapësirave publike, organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

5 qershori “Dita e mjedisit”:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbjellja-e-drunjeve-dekorativ-e-aromatik-ne-hapesira-publike-dhe-pastrimi-nga-hedhurinat-aktivitete-me-porosi-te-carte-per-te-gjithe-ne/>

Dita pa makina:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/dita-pa-makina-ne-prizren/>

Po ashtu EC Ma Ndryshe ka realizuar një storie televizive duke pasqyruar gjendjen reale të Deponisë në Landovicë. Në një raport të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës thuhet se gjendja mjedisore e kësaj deponie nuk është e mirë.

Deponia e Landovicës:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4256312777816291>

EC Ma Ndryshe po ashtu ka realizuar edhe një seri të intervenimeve për mbjellje në hapësira të ndryshme publike duke dhënë kontribut për shtimin e gjelbërimit në qytet.

Aksioni i mbjelljes përgjatë rrugës "Edit Durham":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4587396228041276>

Aksion i mbjelljes në sheshin "Vrapuesja e Prizrenit":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4567236936723872>

Aksion i mbjelljes në rrugën "Ankara":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4618562841591281>

Aksion i mbjelljes në rrugën "Alpet Shqiptare":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4634956179951947>

EC Ma Ndryshe njëkohësisht vazhdon të bëjë pastrimin e hapësirave të ndryshme publike nga mbeturinat në mënyrë të përqimit të mesazhit për ruajtjen e ambientit nga të gjithë.

Aksion pastrimi në lagjen "Bajram Curri":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4163312057116364>

Aksion pastrimi në rrugën "Vesli Klark":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4360199517427616>

Aksion pastrimi në rrugët "Reshat Karjagdiu" dhe "Nazim Pulaj":

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4378543498926551>

Aksion pastrimi në lagjen Arbana:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4552327244881508>

Aksion pastrimi në rrugën 5 Maji:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4574097039371195>

1.8 SIGURIA PUBLIKE

Komiteti i Kartës së Qytetit, në bazë të lajmeve të publikuara nga KK, ka gjetur se siguria publike vazhdon të mbetet shqetësim në Komunën e Prizrenit, me theks në sigurinë rreth shkollave.

Kërkohet patrullimi më i shpeshtë i policisë afër shkollave:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-kerkon-patrullime-policore-me-te-shpeshta-ne-afersi-te-shkollave/>

Komiteti poashtu ka shënuar faktin se Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka vazhduar me takime të rregullta për të diskutuar për situata të ndryshme që prekin komunitetin.

Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/keshilli-komunal-per-siguri-ne-bashkesi-diskuton-situaten-e-krijuar-nga-pandemia-covid-19-dhe-zbatimin-e-rekomandimeve-te-ikshpk-se/>

Ndër zhvillime të tjera mund të potencohen dhënia në shfrytëzim e pronës komunale në Sheshin e Lidhjes për Policinë e Kosovës, me qëllim të operimit sa më të lehtë në qytet si dhe nisma për rrënimin e objekteve me rrezikshmëri për qytetarët.

Ofrimi i zyres Policisë për operim në qendër të qytetit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-i-ofron-zyre-policise-per-operim-ne-qender-te-qytetit/>

Rrënimi i objekteve me rrezikshmëri për jetën e qytetarëve:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/objektet-me-rrezikshmeri-per-jeten-e-qytetaretve-rrenohen/>

1.9 SHËRBIME TË QASSHME PUBLIKE PËR GRUPET E MARGJINALIZUARA, ME THEKS NË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Shënim pozitiv në përmirësimin e shërbimeve publike për grupet e marginalizuara shënon reformimi i administratës lokale, me inagurimin e shërbimeve administrative të ofruara për qytetarë në Qendrën për Një Ndalesë (One Stop Shop). Sidoçoftë, të dhënat nga takimet me këto grupe të komunitetit, flasin për mungesë të qasjes në institucione të tjera lokale dhe privim nga marrja e shërbimeve publike (pjesa e dytë e raportit).

Shërbimet One Stop Shop me infrastrukturë të qasshme për grupet e marginalizuara:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/sherbimet-administrative-per-qytetare-nga-e-hena-ofrohen-ne-objektin-e-administrates/>

1.10 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM URBAN

Realizimi i Parkut në Lakuriq:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,735#.YD0pPOhKiUk>

Shtegu i biçikletave/ Doënhill me gjetësi prej 10km:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/perurohet-faza-e-dyte-e-shtegut-malor-te-bicikletave-me-gjatesi-mbi-10-km/>

Shënimi i Ditës Botërore të Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe organizatën Let's do it Kosova:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/me-shume-aktivitete-komuna-jone-shenoi-diten-nderkombetare-te-mjedisit-jetesor/>

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/jetesimi-i-ambientit-dhe-eleminimi-i-deponive-ilegale-moto-ta-pastrojme-prizrenin/>

Mbjellja e luleve dekorative në hapësirat publike në qytetin e Prizrenit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/gjelberim-dhe-lule-sa-me-shume-ne-hapesirat-publike-te-komunesone/>

Pastrimi i rrugëve nga hedhurinat dhe deponitë ilegale të mbushura me mjete inerte dhe mbeturina të ndryshme:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/pastrohen-rruget-nga-hedhurinat-ilegale/>

Pastrimi dhe rregullimi i disa hapësirave publike në Komunen e Prizrenit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/pastrohen-hapesirat-e-gjelberta-qytetaret-mund-te-pushojne-dhe-freskohen-cilesishte/>

Pastrimi dhe dezinfektimi i rrugëve në fshatra të ndryshme të komunës:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/pastrohen-dhe-dezinfektohen-rruget-ne-fshaterat-e-komunesone/>

Mbjellja e bimëve dekorative me rastin e 22 vjetorit të Epopesë së UÇK-së:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-mbjelle-59-bime-dekorative-aromatike-ne-nderim-te-deshmoreve-te-kombit/>

Pastrimi i Lumbardhit dhe largimit të mbeturinave përreth shtratit të tij:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/pastrohet-lumbardhi-nga-mbeturinat-dhe-hedhurinat/>

Organizimi i punëtorisë në kuadër të projektit “Përkrahje për një Prizren të Qëndrueshëm – Projekti për inicimin e Veprimeve të Duhura Kombëtare për Zbutje Urbane” :

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/prizreni-i-gjelber-prioritet-i-komunesone/>

Mungesa e shtigjeve për biçikleta ka bërë që EC Ma Ndryshe të reagoj përmes performancës publike e cila ka synuar sensibilizimin e qytetarëve që të shmangin përdorimin e makinave, duke adresuar rëndësinë e mbrojtjes së ambientit.

Shumë makina e pak shtigje për biçikleta:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4459886274125606>

Çështje tjetër e ngritur nga EC ka qenë edhe mungesa e shportave për mbeturina , kërkesë kjo e paraqitur shumë here në takimet e rregullta të organizuara me banorë.

Prizreni me shporta, jo vetëm sot:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4463339783780255>

1.11 SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE TË KËNAQSHME PËR QYTETARËT

Në rradhën e angazhimeve/nismave për përmirësim të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, Komiteti i Kartës së Qytetit ka veçuar:

Realizimin e dy shërbimeve të reja në nivel komunal nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, “Holteri” dhe “Ergometria”

“Holteri” dhe “Ergometria” :

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/sherbime-te-reja-shendetesore-holteri-dhe-ergometria-te-cilat-shfrytezohen-per-diagnostikimin-e-semundjeve-te-zemres/>

Realizimi i 20 shtëpive për familjet skamnore, projekt që bazohet në marrëveshjen me shoqatën Jetimat e Ballkanit për vitin 2021.

20 shtëpi për familjet skamnore:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njzete-shtepi-te-reja-per-familjet-skamnore-pa-strehim/>

Realizimi i testeve të shpejta (rapide) antigjen për Covid-19 në shëndetësinë primare.

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/shendeti-i-qytetareve-prioritet-yeni-testet-te-shpejta-antigjen-per-covid-19-behen-ne-shendetesine-primare/>

Ndihma e ofruar për familjet në nevojë përmes ofrimit të materialit ndërimor nga DPMS.

Ndarja e materialit ndërtimor:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-ndihmon-qytetaret-ne-permiresimin-e-kushteve-te-banimit/>

Funksionalizimi i shërbimit geriatrik për herë të parë në Komunën e Prizrenit, për të moshuarit që kanë nevojë për ndihmë mjekësore por nuk kanë mundësi të vijnë deri në Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Shërbimi Geriatrik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/per-here-te-pare-ne-kosove-komuna-e-prizrenit-ofron-sherbimin-geriatrik%e2%80%8b/>

Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike nga Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale për 2600 familje të komunës së Prizrenit nga skema sociale.

Ndihma me pako ushqimore:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-ndihmon-qytetaret-ne-nevoje-me-pako-ushimore-dhe-higjenike/>

Mundësia e realizimit të analizës së vitaminës D, B dhe B12, si dhe analizat e heliobakterieve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Analizat e vitaminës D, B, B12 dhe Heliobakterieve:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/analizat-e-vitamines-d-b-b12-dhe-heliobakterieve-kryhen-ne-qkmf-e/>

Ofrimi i shërbimit të analizave të tumor markerëve, që mundëson identifikimin e hershëm të të gjitha llojeve të kancerit, në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Luftës Kundër Kancerit.

Analizat e tumor markerëve:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/analizat-e-tumor-markereve-tash-ofrohen-ne-qkmf-e/>

Ndërtimi i ambulants së re në fshatin Lubizhdë e Prizrenit.

Ambulanca e re në fshatin Lubizhdë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/perurohet-ambulanca-e-re-ne-fshatin-lubizhde/>

Përrurimi i çerdhes së parë publike në Komunën e Prizrenit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/perurimi-i-cerdhes-se-pare-publike-ne-komunen-e-prizrenit/>

Analizat biokimike edhe në QMF-në e fshatit Gjonaj:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/analizat-biokimike-per-qytetare-ofrohen-edhe-ne-qmf-ne-e-fshatit-gjonaj/>

Renovimi i 34 kulmeve për më shumë se 474 njësi banesore:

[https://kk.rks-](https://kk.rks-gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%91%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%af%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a1%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7-%f0%9d%9f%91%f0%9d%9f%92-%f0%9d%90%a4%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a5%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%9e/)

[gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%91%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%af%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a1%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7-](https://kk.rks-gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%91%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%af%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a1%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7-%f0%9d%9f%91%f0%9d%9f%92-%f0%9d%90%a4%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a5%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%9e/)

[%f0%9d%9f%91%f0%9d%9f%92-](https://kk.rks-gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%91%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%af%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a1%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7-%f0%9d%9f%91%f0%9d%9f%92-%f0%9d%90%a4%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a5%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%9e/)

[%f0%9d%90%a4%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a5%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%9e/](https://kk.rks-gov.net/prizren/news/%f0%9d%90%91%f0%9d%90%a2%f0%9d%90%a7%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%af%f0%9d%90%a8%f0%9d%90%a1%f0%9d%90%9e%f0%9d%90%a7-%f0%9d%9f%91%f0%9d%9f%92-%f0%9d%90%a4%f0%9d%90%ae%f0%9d%90%a5%f0%9d%90%a6%f0%9d%90%9e/)

Pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, ofrohet falas shërbimi adekuat me aparatura të specializuara të Ultrazërit dhe Mamografi, si dhe diagnostikimi bëhet nga mjekja specialiste radiologe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-ofron-falas-sherbime-me-ultraze-dhe-mamografine-kunder-kancerit-te-gjirit/>

1.12 KULTURA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

E drejta për trashëgiminë kulturore mbetet ndër më të cenuarat sa i përket përmbushjes së dispozitave të Kartës së Qytetit. Ndërtimet pa leje kanë vazhduar në kuadër të Qendrës Historike të Prizrenit, përderisa hulumtimet mbi funksionimin e institucioneve të ndryshme në kuadër të këtij fushëveprimi nxjerrin në pah shumë sfida. Ndër të tjera, mbetet në pikëpyetje edhe funksionalizimi apo jo i Zyres së QHPz. Për këto dhe shqetësime të tjera rreth trashëgimisë kulturore ka patur reagime edhe nga shoqëria civile.

Mosfunksionalizimi i zyrës së qendrës historike:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,728#.YD0o60hKiUk>

Ndërtimet pa leje brenda QHPz:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,732#.YD0pHuhKiUk>

Sfidat e shumta të trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit:

<https://ecmandryshe.org/?page=1,17,739#.YD0pruhKiUk>

Sidoqoftë, janë disa nisma të angazhimeve të cilat mund të listohen me ndikim në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore:

Kryetari i Komunës së Prizrenit Mytahir Haskuka, së bashku me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Cagri Sakar dhe kryetarin e Kryesisë së Këshillit Turk në Kosovë, Savas Yanar, kanë bërë përrurimin e renovimit e oborrit të “Namazxhahut”.

Renevohet oborri i “Namazxhahut”:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/renovohet-oborri-i-namazxhahut-objekt-i-trashegimise-kulturore/>

Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka dhe drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Sevil Limani-Kazaz, kanë organizuar aktivitetin “Dimri Kulturor” i cili është mbajtur në sheshin Shatërvan në kuadër të festave të fundvitit.

Dimri kulturor:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/dimri-kulturor-mirepret-qytetaret-dhe-bashkeatdhetaret-ne-sheshin-shatervan/>

Në Muzeun Kombëtar të Kosovës është nënshkruar Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit dhe Plani i Menaxhimit për Kalanë e Prizrenit.

QHP dhe Kalaja me plan menaxhimi të formalizuar ne MKRS:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/qendra-historike-e-prizrenit-dhe-kalaja-me-plan-menaxhimi-te-formalizuar-me-mkrs-ne/>

Është bërë instalimi i ri i ndriçimit në Urën e Gurit.

Ndriçimi i Urës së Gurit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/kryetari-i-komunes-se-prizrenit-mytaher-haskuka-dhe-drejtoresha-drejtorise-se-turizmit-dhe-zhvillimit-ekonomik-sevil-kazaz-kane-bere-lansimin-e-projektit-ndricimi-i-ures-se-gurit/>

Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik ka realizuar kursin e filigranit, i cili ka për qëllim aftësimin profesional të të rinjve në zejen e filigranit dhe ruajtjen e vlerave artizanale të vendit.

Kursi për filigran:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/ftojme-qytetaret-te-aplikojne-ne-kursin-per-perpunimin-e-filigranit/>

Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik ka organizuar aktivitete të ndryshme kulturore në kuadër të verës kulturore “Prizreni 2019”.

Aktivitetet e verës kulturore 2019:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/aktivitetet-e-veres-kulturore-prizreni-2019/>

Për nder të “Festave të qershorit” komuna e Prizrenit ka realizuar aktivitete të ndryshme:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-me-shume-aktivitete-kulturore-shkencore-artistike-e-panaire-po-shenon-pervjetorin-e-lidhjes-shqiptare-te-prizrenit/>

Old timer fest:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/festivale-te-ndryshme-vazhdojne-te-mbahen-ne-kryeqytetin-e-kultures-ne-kosove-ne-prizren/>

EC Ma Ndryshe po ashtu është duke e realizuar trajnimin për punimin e veshjeve tradicionale “Dollama”

Trajnimi për punimin e veshjeve tradicionale “Dollamave”:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe/posts/4596465030467729>

Me qëllim të evaluimit të gjendjes pas funksionimit dy vjeçar të Kartës së Qytetit, Komiteti ka realizuar një seri tjetër takimesh me grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit, të specifikuar sipas Kartës së Qytetit, duke përfshirë këtu: të rinjtë, gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin e kulturës dhe sportit. Me të gjitha këto grupe ka realizuar një pyetësor duke u referuar në qëndrime të caktuara të specifikuar në Kartën e Qytetit, dhe duke vlerësuar në këtë mënyrë nëse ka ndonjë përmirësim të kërkesave/shqetësimeve të parashtruara gjatë takimeve në pjesën e parë të këtij viti.

Fatkeqësisht, të dhënat e dalura nga pyetësori pasqyrojnë një realitet jo të kënaqshëm sa i përket përmbushjes së të drejtave themelore të listuara në kuadër të Kartës së Qytetit.

Përfaqësuesit e grupeve të komunitetit janë përgjigjur se:

- Qytetarët nuk gëzojnë aspak apo gëzojnë mesatarisht të drejtat e tyre në raport me qytetin.
- Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarëse të Komunës së Prizrenit është nën nivelin e dëshirueshëm.
- Grupet e marginalizuara (PAK, të rinjtë, të moshuarit, gratë, grupet minoritare, etj) nuk i gëzojnë aspak të drejtat e tyre në raport me qytetin
- Komuna e Prizrenit ka treguar angazhim minimal dhe me raste mesatar sa i përket përmirësimit të sigurisë publike në dy vitet e fundit.
- Qytetarët nuk gëzojnë aspak apo gëzojnë mesatarisht të drejtën e informimit mbi aktivitetet financiare dhe administrative të Komunës së Prizrenit.
- Komuna nuk është duke ofruar qasje efektive dhe transparente për të gjithë qytetarët në informata dhe dokumente publike.
- Komuna nuk është duke inkurajuar (apo është duke e bërë vetëm formalisht) debate publike, shkëmbim idesh dhe informatash për qytetarët e Prizrenit.
- Komuna ka bërë angazhim minimal me qëllim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm urban.
- Kërkohej ende shumë angazhim në përmirësimin e: transportit publik të qasshëm për të gjithë; hapësirave publike të mjaftueshme dhe të qasshme; ndërtimit të kontrolluar dhe me dispozita ligjore; promovimit të mjedisit të shëndoshë urban; përmirësimit të infrastrukturës fizike dhe sociale; mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore etj.
- Qytetarët gëzojnë mesatarisht të drejtën për strehim dhe shërbime sociale.
- Komuna ka treguar angazhim minimal dhe me raste mesatar në promovimin e agjendës kulturore të qytetit të Prizrenit.

Nga përfaqësuesit e grupeve të komunitetit të intervistuar (përfshirë këtu: Antigona Shestan/OPMDK, Donat Nixha/Kuvendi i të rinjëve, Indira Elshani/Komuniteti i grave RAE, Mimoza Rugova/Down Syndrome Kosova, Musa Jorgaxhi/ Organizata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, Valtida Shukriu/Grupi i grave FEMaktiv, Visar Haxhifazliu/ Rrjeti i Organizatave të Kulturës, Zejxhane Celina dhe Ymrane Fusha/ Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve Prizren, Dren Marseli/Menaxher i Klubit Bashkimi) janë ri-adresuar shqetësimet pothuajse të njëjta sikurse në takimet konsultative gjatë hartimit të Kartës së Qytetit, por edhe gjatë takimeve të organizuara në pjesën e parë të këtij viti duke nxjerr në pah faktin që gjatë këtyre dy viteve nuk është punuar shumë në adresimin dhe mënjanimin e tyre.

Ndër shqetësimet e listuara, të ndara respektivisht në grupet e komunitetit të specifikuar në Kartën e Qytetit, veçohen:

TË RINJTË: E drejta për informim; Transparenca dhe llogaridhënja e pushtetit lokal; Shërbime të mira publike; Hapësira publike multifunkionale dhe të qasshme për të gjithë; Ndërtimi i një qendre rinore të mirëfilltë; Përmirësimi i shërbimit parësor mjekësor; Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje; Rritja e pjesëmarrjes në të gjitha fazat e planifikimit hapësinor; Respektimi i të drejtës për liri të lëvizjes, sidomos për PAK; Avancimi i transportit urban; Shtimi i sigurisë publike; Respektimi i parimit të barazisë gjinore; Respektimi i të drejtave të fëmijëve; Infrastrukturë e mirë edukativo-arsimore; Përmirësim i ofertës turistike të qytetit.

GRATË: Përmirësimi i sigurisë publike; Zbutja e ndotjes akustike në qytet; Sigurimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në ekzekutivin lokal dhe në hartimin e politikave publike; Krijimi i institucioneve parashkollore publike; Shtimi i hapësirave rekreative-argëtuese që i plotësojnë standardet e sigurisë; sigurimi i strehimit dhe mbështetjes sociale për nënat vetëushqyese; Pjesëmarrja në të gjitha fazat e planifikimit urban e hapësinor; Prezenca në kontrollin e investimeve publike; Qasja në shërbimet publike; Trajtimi i çështjes së grave në zonat rurale; Respektimi i kuotës gjinore 50% me 50% siç kërkohet me legjislacion; Përmirësim i mobilitetit.

TË MOSHUARIT: Përmirësimi i shërbimeve publike; Gjelbërimi i hapësirave publike; Menaxhimi më i mirë i mbeturinave; Rregullimin e investimeve të reja në ndriçimin publik; Lirimin e trotuareve të zëna; Eliminimin e ndotjes akustike; Krijimin e një zgjidhje të qëndrueshme për problemin e lypsarëve; Zbatimin e të drejtës në informim; Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; Respektimi i kriterëve urbanistike; Përfshirja e publikut në planifikimin hapësinor; Shtimi i llogaridhënies; Zbatimi i projekteve që mundësojnë mirëqenie dhe përfshirje më të madhe sociale për të moshuarit; Finalizimi i funksionalizimit të Shtëpisë së Pleqve; Krijimi i ekipeve të ndryshme këshilldhënëse që do të mundësonin shfrytëzimin e përvojës së profesionistëve të moshuar e të pensionuar; Krijimin e institucioneve kulturore, edukative e muzeale në qytet.

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA: Respektimi i kuotës së punësimit të PAK; Përkrahje më e madhe e OJQ-ve për PAK; Ofrimi i hapësirave adekuate për punë për OJQ-të për PAK; Përpilimi i një databaze për PAK; Sigurimi i lëvizjes së lirë të PAK në hapësirat dhe ndërtesat publike, përfshirë toalete të qasshme dhe rregullimi i infrastrukturës adekuate; Përdorimi i gjuhës së shenjave në faqen e internetit të Komunës; Lirimi i PAK nga shërbimet komunale (tatimi në pronë, mbeturinat etj.); Sigurimi i parkingjeve për PAK; Garantimi i gjithëpërfshirjes në edukim për PAK; Transporti urban i mundshëm dhe me lehtësime; Bursa për PAK; Shtim i semaforëve akustikë; Shtim i ashensorëve në objektet ekzistuese, duke përfshirë alfabetin e Brailit.

KULTURA DHE SPORTI: Përmirësimi i infrastrukturës kulturore dhe sportive; Masivizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive të rinjtë; Organizimi i aktiviteteve për edukim kulturor në formë koncertesh pedagogjike artistike me performim të Orkestrës së Qytetit; Aktivizimi i teatros së fëmijëve; Komunikim më i mirë me komunitetin kulturor dhe sportiv të qytetit; Shërbime më të mira publike; Përmirësimi i ndriçimit publik; Eliminimi i ndotjes akustike; Ndalim i degradimit të Qendrës Historike; Zbatim i praktikave për mobilitet më të mirë në qytet; Ndërmarrje e masave për shtimin e sigurisë publike me funksionalizimin e kamerave dhe vëzhguesve të sigurisë; Krijim i parkingjeve publike; Krijim i shtigjeve për biçikletave me shenjzim adekuat; Lirimi i hapësirave të zëna publike; Shtimi i hapësirave të gjelbërta; Trajtimi i qenve endacak.

Për dallim nga vlerësimet e lart shënuara (nën nivel të kënaqshëm apo mesatar) nga ana e përfaqësuesve të grupeve specifike të komunitetit, të specifikuara sipas Kartës së Qytetit, drejtorët e Drejtorive Komunale në Prizren janë përgjegjur me qëndrime diametralisht të kundërta, duke e cilësuar angazhimin e Komunës së Prizrenit me angazhim të lartë dhe gjendje aktuale mbi mesatare. Pyetësi i njejtë i ndarë me të gjitha drejtoritë (por me përgjegje vetëm nga Beni Kizolli/ Drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Islam Thaqi/ Drejtorja për Punë dhe Mirqenië Sociale, Osman Hajdari/ Drejtorja e Administratës, Edon Muçaj/ Drejtorja e Inspektoriateve, Sevil Kazaz/ Drejtorja për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik), vë në pah një lloj vetë-kënaqësie institucionale karshi realitetit të kundërt të reflektuar nga qytetarët.

KONKLUZA

Komiteti i Kartës së Qytetit vlerëson se përkundër nismave dhe angazhimeve të Komunës së Prizrenit me institucionet relevante, përmbushja e të drejtave të specifikuar sipas Kartës së Qytetit ende lë shumë për tu dëshiruar (bazuar në evaluimin e bërë në periudhën dy vjeçare pas miratimit të dokumentit në fjalë).

Edhe pse angazhimi në monitorimin e situatës ka qenë ngusht i ndikuar nga situata pandemike në vend, Komiteti vlerëson se ekzistimi i trupës monitoruese është më se i domodsoshëm dhe se validiteti i Kartës së Qytetit është vlerë e shtuar për një qeverisje demokratike në Komunën e Prizrenit.